



Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Delivary	27.06.2022	2	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	3754/2022		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.544/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.544/2022 të datës 17.06.2022 të parashtruar nga ankuesja [redacted] me adresë [redacted] kundër Vendimit me Nr.28/2022 të datës 14.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.544/2022 e datës 17.06.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.28/2022 i datës 14.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

### A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] kandidate për pranim në Shërbimin Civilë, më datë 17.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3572/2022 e regjistruar me numër A.nr.544/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.28/2022 të datës 14.06.2022 të Njesisë së Burimeve Njerëzore pranë Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 22.06.2022 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, ndërsa më datë 23.06.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses me numër protokoli:3572/2022 të datës 17.06.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; CV-në e ankueses; Vendimin me Nr. 24/2022 i datës 09.06.2022 nga Njësia e Burimeve Njerëzore; Vendimin me Nr.28/2022 i datës 14.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 22.06.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 23.06.2022; Vendimin me Nr.11/2022 i datës 21.04.2022; Konkursin për Specialist Ligjor me numër Reference: RN00008856 i datës 21.04.2022; Lista e aplikantëve të aprovuar dhe refuzuar; Njoftimin e datës 09.06.2022; Ankesën e datës 13.06.2022 të ankueses për Njësinë e Burimeve Njerëzore; Aplikacionin e ankueses i datës 25.05.2022; Vendimin me Nr.02/2022 i datës 01.02.2022; Vendimin me Nr.61/2021 i datës 07.12.2021 për themelim të Komisionit të Pranimit.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga administrimi i provave të lëndës ka gjetur se Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, më datë 21.04.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), ka publikuar njoftimin sipas të cilit nga data 12.05.2022 deri më datë 25.05.2022 do të lejohet aplikimi në konkursin me numër referencë: RN00008856 për grupin e pozitave "Specialist Ligjor" gjegjësisht "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale në Ferizaj. Po ashtu nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar se për pozitën përkatëse të punës, me datë 25.05.2022 ka aplikuar edhe ankuesja, me numër të aplikacionit RAN0004921.

Njësia e Burimeve Njerëzore me Vendimin Nr.24/2022 të datës 09.06.2022 ka refuzuar aplikacionin e ankueses për shkak të dosjes së pakompletuar. Ankuesja kundër këtij vendimi, më datë 13.06.2022 ka parashtruar ankesë tek Njësia e Burimeve Njerëzore, ndërsa kjo e fundit më datë 14.06.2022 me Vendimin me Nr.28/2022 ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e ankueses me arsyetimin se e njëjta me rastin e aplikimit nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi në bazë të cilave do të verifikohet plotësimi i kriterëve të parapara me konkursin e datës 21.04.2022.

Kundër Vendit me Nr.28/2022 të datës 14.06.2022 ankuesja ka parashtruar ankesë pranë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se refuzimi i aplikacionit është bërë me prapavijë vetëm e vetëm për ta pranuar kandidatin e parapërcaktuar; Vendimi është marr nga një individ nga Drejtoresha e Departamentit të Shërbimeve Juridike e vetëshpallur si Kryetare; Këshilla juridike e vendimit nuk ka mbështetje ligjore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka analizuar dosjen e lëndës dhe rrjedhimisht duke ju referuar konkursit publik të shpallur për grupin e pozitave "Specialist Ligjor" gjegjësisht "Zyrtar Ligjor 2" në Zyrën Rajonale në Ferizaj, gjegjësisht piken 3 të këtij konkursi ka konstatuar se kërkesat e përgjithshme formale për pranim kanë qenë: "Arsimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare, Fakulteti Juridike me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to...Përvoja e punës së kërkuar: se paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën

*për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë", ndërsa në piken 7 të konkursit është përcaktuar dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim, si: "Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore, Kopjet e dëshmisë së punësimit, Kopjet e dëshmisë së trajnimeve, Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit, Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende, Certifikatën nga evidenca e personave kundër të cilëve është duke u zhvilluar procedura penale dhe personave të dënuar, nga gjykata kompetente".*

Nga administrimi i provave të lëndës është konstatuar se ankuesja me datë 25.05.2022 ka aplikuar për pozitën përkatëse të punës, mirëpo Kolegji nuk ka gjetur ndonjë provë që vërteton se e njëjta me rastin e aplikimit, përveç aplikacionit të ketë dorëzuar edhe dokumentet tjera siç përcaktohet me nenin 12 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, 2.2 dhe 2.3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe siç është kërkuar në piken 7 të konkursit, përmes të cilave dokumente do të vërtetohej plotësimi i kushteve të konkursit. Andaj, Kolegji vlerëson se njësia përgjegjëse në këtë rast Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacion të ankueses, për shkak të mungesës së dokumentacionit përcjellës ka vepruar në pajtim me nenin 15 paragrafi 1, 2 dhe 5 ndërlidhur me nenin 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe se pretendimi ankimor i ankueses në këtë kuptim është i pa bazuar.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se vendimi për refuzimin e aplikacionit është marr nga një individ, gjegjësisht nga Drejtoresha e Departamentit të Shërbimeve Juridike, Kolegji analizoje shkresat e lëndës dhe rrjedhimisht konstatoi se [redacted] Drejtoresh e Departamentit Ligjor në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas sipas Vendimit me Nr.210-02 të datës 23.10.2019 dhe V.nr.02/2022 të datës 01.02.2022 është caktuar që të ushtroj detyrën e Menaxherit të Personelit në Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, ndërsa në bazë të Vendimit me Nr.61/2021 të datës 07.12.2021 e njëjta është caktuar kryesuese e Komisionit të Pranimit. Andaj, Kolegji vlerëson se caktimi i nëpunëses civile [redacted] kryesuese e Komisionit të Pranimit është në harmoni me kërkesat formale ligjore të përcaktuara me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenin 17 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 ku përcaktohet se: 2. Komisionet e Pranimit në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhen nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin...". Ndërsa me nenin 15 paragrafi 6 të kësaj rregullore përcaktohet se: 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrahet me shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj. Kolegji duke u bazuar në dispozitat përkatëse ligjore konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, ka kompetencë të plotë që të shqyrtoj ankesat e kandidatëve të cilët janë njoftuar se nuk i plotësojnë kushtet e aplikimit, dhe në këtë kuptim edhe nëpunësja civile [redacted] luke qenë e caktuar me akt administrativ si përgjegjëse për ushtrimin e detyrave të Menaxherit të Personelit, me rastin e trajtimit të ankesës ka vepruar në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, kështu që pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se këshilla juridike e vendimit kontestues nuk ka mbështetje ligjore, konstaton se Vendimi me Nr.28/2022 i datës 14.06.2022 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në kuadër të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, përmban të gjitha elementet e aktit administrative, duke përfshi edhe udhëzimin për ushtrimin e mjeteve juridike siç përcaktohet me nenit 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se në rrethanat e rastit konkret ankueses nuk i është cenuar asnjë e drejtë për shfrytëzimin e mjeteve juridike andaj pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.544/2022

Avdyj BEKTESHI

Procesmbajtës

Jeton KOÇA

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.